

VENDIM
Nr. 31, datë 9.3.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BALLENJA
POWER MARTANESH” SHPK, NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “ç” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “f”; 5, pika 1 germa “f”; 10, pika 3, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr.108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.3.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ballenja Power Martanesh” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC “Ballenja”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Ballenja Power Martanesh” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/9, gerrat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Ballenja Power Martanesh” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike nga HEC “Ballenja”.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti